



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 163/4 prot.

Tiranë më 9.2.2018

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 9.2.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 39, datë 24.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Zyra Përmbartimore Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Zyra Përmbartimore Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr. 39, datë 24.01.2018 të Komisionerit. Kontrolluesi Zyra Përmbartimore Tiranë, në ushtrim të detyrës së saj, ka kryerjen e shërbimit përmbartimor gjyqësor dhe konkretisht, ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë.

Ky shërbim, ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 26 “Mbledhja dhe administrimi i të dhënave” i Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, shprehet:

“1. Përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organet e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë, entet publike, si dhe personat fizikë e juridikë që kanë dokumente dhe të dhëna që lidhen me ekzekutimin, janë të detyruar t'i paraqesin kur u kërkohen nga përmbaruesit gjyqësorë.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen grumbullohen, administrohen, ruhen dhe/ose asgjësohen, në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi”.

Ky nen i jep përmbaruesit gjyqësor të drejtën e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke patur parasysh respektimin dhe garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, Zyra Përmbarimore Tiranë, është kontrollues i cili mbledh dhe grumbullon të dhëna personale të kategorive *“punonjës dhe përmbarues gjyqësor”* dhe *“subjekte që marrin pjesë në ekzekutim”*.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 31.01.2018 u konstatua:

1. Kontrolluesi Zyra Përmbarimore Tiranë, nuk disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi Zyra Përmbarimore Tiranë, nuk ka nënshkruar *“Deklaratë Konfidencialiteti”* me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.

Përfaqësuesi i kontrolluesit Zyra Përmbarimore Tiranë, nuk paraqiti pretendime në lidhje me konstatimet e shprehura dhe të lexuara në prani të palëve të procesverbalit në fjalë.

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbarimore Tiranë, të hartojë Rregulloren për *“Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”*.
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbarimore Tiranë, të nënshkruajë *“Deklaratat e Konfidencialitetit”* me punonjësit dhe përmbaruesit gjyqësor, sipas

- standardit të përcaktuar në Vendimin Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit, për "Përcaktimin e rregullave të Hollësishme për Sigurimin e të Dhënave Personale".
3. Kontrolluesi Zyra Përmbarimore Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
 4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 9/2/2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

